## *Cilj inspekcijskog badzora zasnovanom na riziku*

Inspekcija zasnovana na riziku ima za cilj minimizaciju intervencija na subjektu inspekcije, uz garantovanje da se pravila sprovode.
Inspekcijski nadzor zasnovan na riziku kombinuje procenu verovatnoće neuspeha sa posledicama potencijalnog neuspeha.

## *Metoda Inspekcijskog nadzora zasnovanom na riziku*

Inspekcijski nadzor zasnovan na riziku ispituje moguće izvore problema i izbegava ih pre nego što se dogode. Ovaj tip inspekcije razvija šemu inspekcije, koja se zasniva na znanju o riziku neuspeha, vrsti štete koja može biti prisutna, gde bi mogla da se dogodi takva šteta, stepenu u kojem bi se mogla razviti takva šteta, gde bi neuspeh izazvao rizik.

## *Uticaj inspekcijskog nadzora zasnovanom na riziku*

Pomoću inspekcijkog nadzora zasnovanom na riziku se planiraju mere za smanjenje rizika i sprečavanje mogućih šteta.
Rizik je kombinacija mogućnosti da se dogodi neželjeni događaj i veličine, ozbiljnosti štete koju bi mogao da izazove ako se ovaj događaj desi.

## *Glavni dokument inspekcije*

Kontrolna lista je ključni dokument na osnovu kojeg se vrši inspekcijski nadzor i određuje delokrug inspekcijskog nadzora.
Kontrolna lista se sastavlja i odobrava od strane inspekcijskih organa u konsultaciji sa Kancelarijom generalnog inspektora u Republici Kosovo.

## *Prilagođavanje subjektima inspekcije*

Kontrolne liste se prilagođavaju vrsti aktivnosti subjekata inspekcijskog nadzora i objektu gde se vrši inspekcija, i zasnivaju se na metodologiji zasnovanoj na riziku. Kontrolne liste uključuju tačke na koje će se inspekcija fokusirati.
Iako je kontrolna lista glavni vodič tokom inspekcijskog nadzora, inspektor može otvoriti druge oblasti inspekcije, ako se proceni da je to potrebno za zaštitu javnog interesa, javnog zdravlja, sigurnosti ili okoline.

## *Odustajanje od kontrolne liste*

U slučajevima odstupanja od kontrolne liste, inspektor mora detaljno objasniti ovu odluku u zapisniku inspekcije.

## Kontakt


E-mail: info.zip@rks-gov.net

Telefon: +383 (0) 38 200 14 500

Website: https://inspektorati.rks-gov.net/

Adresa: Sheshi "Nëna Terezë", Ndërtesa e Qeverisë, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

ZIP
ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG INSPEKTORA
OFFICE OF THE GENERAL INSPECTOR



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

ZIP
ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG INSPEKTORA
OFFICE OF THE GENERAL INSPECTOR


# KANCELARIJA GENERALNOG INSPEKTORA U REPUBLICI KOSOVO

Kancelarija generalnog inspektora je izvršna agencija u okviru Kancelarije Premijera Vlade Republike Kosovo, koja pomaže u koordinaciji sistema o inspekcijskom nadzoru u zemlji. Misija Kancelarije generalnog inspektora je da vodi program reforme inspekcije, koordinira i podržava aktivnosti inspekcijskih organa sa krajnjim ciljem smanjenja administrativnog opterećenja inspekcija, u cilju zaštite javnog interesa, uključujući javno zdravlje, javnost, bezbednost i životnu sredinu na celoj teritoriji Republike Kosovo.

## DUŽNOSTI I ODGOVORNOSTI

Kancelarija generalnog inspektora vodi program reforme inspekcija, pruža podršku relevantnim ministarstvima, opštinama, izvršnim i regulatornim agencijama, te koordinira i podržava aktivnosti inspekcijskih organa.
Inspekcijski organi u Republici Kosovo vrše inspekcijski nadzor na osnovu sledećih osnovnih principa, kako bi obezbedili transparentnost, kompatibilnost i pravičnost za sve tokom inspekcijskog nadzora.

## OSNOVNA NAČELA INSPEKCIJSKOG NADZORA:

### *Transparentnosti*

Inspekcijski organi dele sa javnošću informacije o inspekcijama uz zaštitu ličnih podataka i tajnosti inspekcija.

### *Nezavisnosti i profesionalizma*

Inspektori se ponašaju profesionalno i nezavisno bez uticaja politike i drugih strana.

### *Srazmernosti*

Inspekcije nastoje da budu efikasne sa minimalnim intervencijama kod inspekcija, na osnovu težine, posledica, i okolnosti prekršaja.

### *Koordinacije i racionalizacije*

Koordinacijom inspekcija, inspekcijski organi eliminiraju dupliciranje posla i povećavaju efikasnost dostupnih resursa.

### *Pristupa zasnovanog na riziku*

Inspekcije u Republici Kosovo se planiraju na osnovu nivoa rizika, razvrstavajući subjekte inspekcije u skladu sa postojećim okolnostima.

### *Podrške nadziranih subjekata*

Inspekcijski organi nastoje da pomognu subjektima inspekcije da postignu kompatibilnost pružajući smernice, informacije, i tehnološka sredstva.

### *Inspekcije zasnivane na dokazima*

Inspekcijski organi na Kosovu vrše objektivne procene bazirane na dokazima i održivim merenjima.

### *Načelo planiranja inspekcijskih nadzora*

Nadzirani subjekti mogu podleći inspekcijskom nadzoru samo primenom plana inspekcijskog nadzora.
Izuzetno, nadzirani subjekti mogu.

### *Načelo najpovoljnije zakonske odredbe*

Kada zakonske odredbe, na osnovu kojih se sprovodi inspekcijski nadzor su nejasne ili su protivurečne, inspektor postupa na način koji najmanje ugrožava nadzirani subjekat i kada je nadzirani subjekat postupio u skladu.

## VRSTE INSPEKCIJE

### *Planiranog inspekcijskog nadzora*

U slučajevima kada su zakoni nejasni ili kontradiktorni, inspekcijski organi deluju samo prema planu inspekcije, izuzev zakonom predviđenim slučajevima. Planirane inspekcije garantuju kvalitet i poštovanje zakona, koristeći pristuo zasnovan na riziku.

### *Vanrednog inspekcijskog nadzora*

Takođe, postoje i vanredni inspekcijski nadzor koji mogu biti iznenadni i to iz važećih razloga.
Ove inspekcije mogu biti odobrene u vanrednim situacijama kada postoji sumnja na prekršaj zakona ili kada je ugrožen javni interes.

### *Zajedničkog inspekcijskog nadzora*

U određenim slučajevima, Kancelarija generalnog inspektora i inspekcijski organi u Republici Kosovo mogu se udružiti sa drugim institucijama kako bi sproveli zajednički inspekcijski nadzor i obezbedili sveobuhvatan nadzor.

### *Ponovnog inspekcijskog nadzora*

Ponovni inspekcijski nadzor je još jedan proces koji ima za cilj verifikaciju korekcija prekršaja otkrivenih u prethodnoj inspekciji.
Ponovni inspekcijski nadzor može biti sproveden samo nakon isteka roka koji je dodeljen subjektu inspekcije za ispravku prekršaja otkrivenih u poslednjem zapisniku inspekcije. Ponovni inspekcijski nadzor i rok za ispravku ne isključuju inspekcijski nadzor za druge prekršaje.

## INSPEKCIJSKI NADZOR ZASNOVAN NA RIZIKU I KONTROLNA LISTA

Inspekcijski nadzor zasnovan na riziku je metoda koja se koristi za poboljšanje javnog interesa, koji ima za cilj ublažavanje aktuelnih ili mogućih rizika, koji mogu da ugroze javne interese, posebno ljudsko zdravlje, sigurnost i okolinu.

## *Objektivi i inspektimit të bazuar në rrezik*

Inspektimi i bazuar në rrezik ka për objektiv minimalizimin e ndërhyrjeve tek subjekti i inspektimit, por duke garantuar se rregullat po zbatohen. Inspektimi i bazuar në rrezik kombinon vlerësimin e gjasave të dështimit me pasojat e një dështimi potencial.

## *Metoda e Inspektimit të Bazuar në Rrezik*

Inspektimi i bazuar në rrezik i hulumton burimet e mundshme të problemeve dhe i shmang ato para se të ndodhin. Ky lloj inspektimi e zhvillon një skemë inspektimi, e cila bazohet në njohuritë mbi rrezikun e dështimit, lloji i dëmit që mund të jetë i pranishëm, ku mund të ndodhë një dëm i tillë, shkallën me të cilën mund të zhvillohet një dëm i tillë, ku dështimi do të shkaktonte rrezik.

## *Ndikimi i inspektimit të bazuar në rrezik*

Me ndihmën e inspektimit të bazuar në rrezik planifikohen masat për zvogëlimin e rrezikut dhe parandalimin e dëmeve të mundshme.
Rreziku është kombinimi i mundësisë së ndodhjes së ngjarjes së padëshiruar dhe madhësisë, ashpërsisë së dëmit që mund të shkaktojë nëse ndodh kjo ngjarje.

## *Dokumenti kryesor i inspektimit*

Lista e kontrollit është dokumenti kyç që përcakton fushëveprimin e inspektimit dhe që shërben për regjistrimin e rrjedhës së inspektimit.
Lista e kontrollit hartohet dhe miratohet nga organet inspektuese në konsultim me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm në Republikën e Kosovës.

## *Përshtatja me subjektet e inspektimit*

Listat e kontrollit përshtaten për llojin e veprimtarisë dhe objektin e inspektimit dhe bazohen në një metodologji të bazuar në rrezik.
Listat e kontrollit përfshijnë pikat ku do të fokusohet inspektimi.
Përkundër që lista e kontrollit është udhëzuesi kryesor gjatë inspektimit, inspektori mund të hapë sfera të tjera të inspektimit, nëse vlerësohet se kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik, shëndetin publik, sigurinë apo mjedisin.

## *Devijimi nga lista e kontrollit*

Në rastet kur bëhet devijim nga lista e kontrollit, inspektori duhet ta arsyetojë në detaje këtë zgjedhje në procesverbalin e inspektimit.

## Kontakti


E-mail: info.zip@rks-gov.net

Telefon: +383 (0) 38 200 14 500

Website: https://inspektorati.rks-gov.net/

Adresa: Sheshi “Nëna Terezë”,
Ndërtesa e Qeverisë, Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

ZIP
ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG INSPEKTORA
OFFICE OF THE GENERAL INSPECTOR



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada-Government*
*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

ZIP
ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG INSPEKTORA
OFFICE OF THE GENERAL INSPECTOR


# ZYRA E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS DHE INSPEKTIMET

Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm është Agjenci Ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, e cila ndihmon në koordinimin e sistemit të inspektimeve në vend. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm ka për mision të drejtojë programin e reformës së inspektimit, të koordinojë dhe mbështesë aktivitetet e organeve inspektuese me objektivin përfundimtar uljen e barrës administrative mbi inspektimet, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, përfshirë shëndetin publik, publikun, sigurinë dhe mjedisin në territorin e Republikës së Kosovës.

## DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm e udhëheq programin e reformës së inspektimit, ofron mbështetje për ministritë përkatëse, komunat, agjencitë ekzekutive dhe agjencitë rregullatore, si dhe koordinon dhe mbështet aktivitetet e organeve të inspektimit.
Organet inspektuese në Republikën e Kosovës kryejnë inspektime duke u bazuar në parimet e mëposhtme themelore, për të siguruar transparencë, pajtueshmëri dhe drejtësi për të gjithë, gjatë procesit të inspektimit.

## PARIMET E INSPEKTIMIT:

### *Transparencë*

Organet e inspektimit i ndajnë me publikun informacionet lidhur me inspektimet, duke i ruajtur të dhënat personale dhe sekretet e subjektit të inspektimit.

### *Pavarësi dhe Profesionalizëm*

Inspektorët veprojnë në mënyrë profesionale dhe të pavarur pa u ndikuar nga politika dhe palë të tjera.

### *Proporcionaliteti*

Inspektimet synojnë të jenë efikase me ndërhyrje minimale tek subjektet e inspektimit duke u bazuar në ashpërsinë, pasojat dhe rrethanat e shkeljes nga subjekti i inspektimit.

### *Koordinimi dhe racionalizmi*

Duke koordinuar inspektimet, organet inspektuese e eliminojnë punën e dyfishtë dhe e rrisin efikasitetin e burimeve në dispozicion.

### *Qasje e bazuar në rrezik*

Inspektimet në Republikën e Kosovës planifikohen sipas niveleve të rrezikshmërisë, duke i ndarë subjektet e inspektimit në përputhje me rrethanat ekzistuese.

### *Mbështetjen për subjektet e inspektimit*

Organet inspektuese synojnë t'i ndihmojnë subjektet e inspektimit për të arritur pajtueshmërinë duke u ofruar udhëzime, doracakë, dhe mjete teknologjike.

### *Inspektimet e bazuar në prova*

Organet inspektuese në Kosovë bëjnë vlerësime objektive të bazuara në prova dhe matje të qëndrueshme.

### *Planifikimi i insepktimeve*

Subjektet e inspektimit mund të inspektohen vetëm në zbatim të planit të inspektimit. Përjashtimisht, subjektet e inspektimit mund të inspektohen jashtë planit në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj.

### *Dispozita më e favorshme ligjore*

Kur dispozitat ligjore, në bazë të cilave zhvillohet inspektimi janë të paqarta apo bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, inspektori vepron në mënyrën që cenon më pak subjektin e inspektimit dhe kur subjekti i inspektimit ka vepruar në përputhje me një dispozitë ligjore që bie në kundërshtim me një dispozitë tjetër ligjore, veprimi i tij nuk konsiderohet shkelje e ligjit.

## LLOJET E INSPEKTIMIT

### *Inspektimet e planifikuara*

Në raste kur ligjet janë të paqarta apo kundërthënëse, organet inspektuese veprojnë vetëm sipas planit të inspektimit, përjashtim bëjnë rastet e parashikuara me ligj. Inspektimet e planifikuara garantojnë cilësinë, dhe respektimin e ligjit, duke përdorur qasje të bazuar në rrezik.

### *Inspektimet e paplanifikuara*

Ekzistojnë edhe inspektimet e paplanifikuara, të cilat mund të jenë të papritura dhe kjo ndodh për një arsye të qëndrueshme. Këto inspektime mund të miratohen në raste të jashtëzakonshme kur ekziston dyshimi për shkelje të ligjit ose kur rrezikohet interesi publik.

### *Inspektimet e përbashkëta*

Në raste të caktuara, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe organet inspektuese në Republikën e Kosovës mund të bashkohen me institucione të tjera për të kryer inspektime të përbashkëta dhe të sigurojnë mbikëqyrje gjithëpërfshirëse.

### *Riinspektimi*

Riinspektimi mund të kryhet vetëm pas skadimit të afatit kohor që i është caktuar subjektit të inspektimit për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e inspektimit të fundit. Riinspektimi dhe afati i korrigjimit nuk e përjashtojnë inspektimin për shkelje të tjera.

## INSPEKTIMI I BAZUAR NË RREZIK DHE LISTA E KONTROLLIT

Inspektimi i Bazuar në Rrezik (IBRr), është një metodë që përdoret për përmirësimin e mirëqenies publike, që synon zbutjen e rreziqeve aktuale ose atyre të mundshme, që mund t'i rrezikojnë interesat publike, në veçanti shëndetin e njeriut, sigurinë dhe mjedisin.